



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.

Durrës, më _____.____.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[01.12.2022]

Drejtuar: K.TURJA me NIPT: K81314014A, me adrese: Durrës Bubq BUDULL Budull, pranë Ures se Gjoles

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Punë”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-47116-10-24-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion Rruga Leke Dukagjini” Rrashbull, **Fondi limit: 7’083’276** (shtatë milion e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, **pa TVSH dhe Kohëzgjatja e kontratës 24** (ditë)

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini datë **31 Tetor** 2022 , Nr. 149

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. CAUSHI M me NIPT L884198010

me vlerë të ofertës 4’250’400 lekë

- | | |
|--|------------------------------------|
| 2. VARAKU E me NIPT J61902509S | me vlerë të ofertës 4'815'200 lekë |
| 3. K.TURJA me NIPT K81314014A | me vlerë të ofertës 5'377'600 lekë |
| 4. L.T.E CONSTRUCTION me NIPT L78006801F | me vlerë të ofertës 5'575'400 lekë |
| 5. MF INVEST GROUP me NIPT L71830010R | me vlerë të ofertës 5'577'600 lekë |
| 6. RROKU GUEST me NIPT K87921701H | me vlerë të ofertës 5'666'200 lekë |
| 7. SARK me NIPT K52531415H | me vlerë të ofertës 5'986'744 lekë |
| 8. ASI-2A CO me NIPT K53002402C | me vlerë të ofertës 6'304'000 lekë |

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. VARAKU E me NIPT J61902509S me vlerë të ofertës 4'815'200 lekë

Arsyjet: Për ofertuesin **VARAKU E me NIPT J61902509S**, me vlerë të ofertës **4'815'200 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, ofertuesi **VARAKU E**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.c të Kapacitetit Teknik ku citohet se *“Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: Inxhinier Ndertimi 1 (një)”*, pasi inxhinieri i ndertimit i paraqitur dhe vetedeklaruar në përmbushje të këtij kriteri, është i angazhuar në kontratën me objekt “Rikonstruksion rruga Dervish Hima”.

2. Nuk përmbush piken 2.3.d të Kapacitetit Teknik ku citohet se *“Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: Inxhinier Gjeodet 1 (nje); Teknik ndertimi 1 (nje)”*, pasi inxhinieri gjeodet dhe tekniku i ndertimit të paraqitur dhe vetedeklaruar në përmbushje të këtij kriteri, janë të angazhuar në kontratën me objekt “Rikonstruksion rruga Dervish Hima”.

3. Nuk përmbush piken 2.3.e të Kapacitetit Teknik ku citohet se *“Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Punëtori e specializuar me makineri, Manovratorë 3 (tre); Drejtues mjeti 3 (tre); Punetore të thjeshtë 22 (njëzetë e dy)”*, pasi drejtuesit e mjeteve dhe punetoret e thjeshtë të paraqitur dhe vetedeklaruar në përmbushje të këtij kriteri, janë të angazhuar në kontratën me objekt “Rikonstruksion rruga Dervish Hima”.

4. Nuk përmbush piken 2.3.g të Kapacitetit Teknik ku citohet se *“Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Automjete vetshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton Copë 1; Automjete vetshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 7.5-18 ton Copë 1; Automjete vetshkarkuese me mase maksimale të autorizuar mbi 18 ton Copë 2; Graider Copë 1; Eskavator me goma Copë 1; Mini eskavator Copë 1; Fadrom me goma, Copë 1; Asfaltoshtruese Copë 1; Kamion me cisterne uji Copë 1; Rul me vibrim Copë 1”*, pasi:

- Automjeti me targe AA984ZZ, i paraqitur dhe vetedeklaruar si Automjet vetshkarkues me mase maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton, është i angazhuar në kontratën me objekt “Rikonstruksion rruga Dervish Hima”.

- Mjeti me targe AA345LB, i paraqitur dhe vetedeklaruar si Automjet vetshkarkues me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton, eshte i angazhuar ne kontraten me objekt "Rikonstruksion rruga Dervish Hima".
- Mjeti me targe AIMS53, i paraqitur dhe vetedeklaruar si Graider, eshte i angazhuar ne kontraten me objekt "Rikonstruksion rruga Dervish Hima".
- Mjeti me targe ADMT44, i paraqitur dhe vetedeklaruar si Eskavator me goma, eshte i angazhuar ne kontraten me objekt "Rikonstruksion rruga Dervish Hima".
- Mjeti me targe AA781III, i paraqitur dhe vetedeklaruar si Kamion me cisterne uji, eshte i angazhuar ne kontraten me objekt "Rikonstruksion rruga Dervish Hima".

KVO vendos qe ofertuesi VARAKU E të mos kualifikohet.

2. L.T.E CONSTRUCTION me NIPT L78006801F me vlerë të ofertës 5'575'400 lekë

Arsyjet: Për ofertuesin L.T.E CONSTRUCTION me NIPT L78006801F, me vlerë të ofertës 5'575'400 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, ofertuesi L.T.E CONSTRUCTION:

1. Nuk permbush piken 2.3.e te Kapacitetit Teknik ku citohet se "Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Punëtori e specializuar me makineri, Manovratorë 3 (tre); Drejtues mjeti 3 (tre); Punetore te thjeshte 22 (njëzetë e dy)", pasi per punonjesit Manovratorë 3 (tre) dhe Drejtues mjeti 3 (tre) ka vetedeklaruar ne total 5 punonjes, nga 6 te kerkuar.

2. Nuk permbush piken 2.3.g te Kapacitetit Teknik ku citohet se "Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 3.5-7.5 ton Copë 1; Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton Copë 1; Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar mbi 18 ton Copë 2; Graider Copë 1; Eskavator me goma Copë 1; Mini eskavator Copë 1; Fadrom me goma, Copë 1; Asfaltoshtruese Copë 1; Kamion me cisterne uji Copë 1; Rul me vibrim Copë 1", pasi nuk ka vetedeklaruar mjetet Graider dhe Asfaltoshtruese ne permbushje te ketij kriteri.

KVO vendos qe ofertuesi L.T.E CONSTRUCTION të mos kualifikohet.

3. MF INVEST GROUP me NIPT L71830010R me vlerë të ofertës 5'577'600 lekë

Arsyjet: Për ofertuesin MF INVEST GROUP me NIPT L71830010R, me vlerë të ofertës 5'577'600 lekë, me vlerë të ofertës 5'575'400 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, ofertuesi MF INVEST GROUP:

1. Nuk permbush piken 2.3.g te Kapacitetit Teknik ku citohet se "Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 3.5-7.5 ton Copë 1; Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton Copë 1; Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar mbi 18 ton Copë 2; Graider Copë 1; Eskavator me goma Copë 1; Mini eskavator Copë 1; Fadrom me goma, Copë 1; Asfaltoshtruese Copë 1; Kamion

me cisterne uji Copë 1; Rul me vibrim Copë 1”, pasi nuk ka vetedeklaruar mjetin Kamion me cisterne uji ne permbushje te ketij kriteri.

KVO vendos qe ofertuesi MF INVEST GROUP të mos kualifikohet

4. RROKU GUEST me NIPT K87921701H me vlerë të ofertës 5’666’200 lekë

Arsyjet: Për ofertuesin **RROKU GUEST me NIPT K87921701H**, me vlerë të ofertës **5’666’200 lekë**, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterave per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, ofertuesi **RROKU GUEST:**

1. Nuk permbush piken 2.3.h te Kapacitetit Teknik ku citohet se “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata: Certifikat: ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë; Certifikat: ISO 18001/45001 - Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë; Sistemi i manaxhimit te sigurise se trafikut rrugor ISO 39001*”, pasi nuk ka paraqitur Certifikaten ISO 18001/45001 ne permbushje te ketij kriteri.

KVO vendos qe ofertuesi RROKU GUEST të mos kualifikohet.

5.CAUSHI M me NIPT L88419801O me vlerë të ofertës 4’250’400 lekë

-Arsyjet: Në pergjigje te ofertës anomalisht te ulët, ofertuesi **CAUSHI M**, me vlerë të ofertës **4’250’400 lekë**, ka argumentuar vleren e ofertës anomalisht te ulët, duke dhene shpjegime dhe analizat teknike te cmimeve per zerat e punimeve.

KVO nuk pranon te vlefshem shpjegimin e ofertes per anomalisht te ulet, sipas arsyesimit te meposhtem.

Në zërin e punës 3.226/1 - Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, t=4cm, perhapur e ngjeshur me makineri, eshte ofertuar 850 lekë/m2, me zërin material asfaltbeton me çmimin 6500 lekë/ ton dhe bitum 55 lek/kg.

Duke e krahasuar me çmimin 1397 lekë/m2, sipas MANUALIT TEKNIK TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE, të miratuar me VENDIM Nr. 629, datë 15.7.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) (i përditësuar), ulja nga manuali eshte 39.2%.

Po të marrim në shqyrtim zërin material asfaltbeton me çmimin e ofruar 6500 lekë/ton, ku në manual është llogaritur 11242 lekë/ton, ulja nga manuali është 42.2%. Kurse për materialin bitum me çmimin e ofruar 55 lekë/kg, ulja nga manuali eshte 35.5%.

Vlen per tu thkesuar fakti se çmimet e materialeve janë rritur dhe sidomos ato të përcaktuara në AKTIN NORMATIV Nr. 10, datë 18.5.2022 (hekuri, çimento, bitumi, alumini, bakri dhe zinku). Në procedurën ne fjale, materialet e çimentos dhe bitumit janë përbëres kryesor, të cilët ndikojnë në vlerën ekonomike të ofertuar.

Në zërin e punës 3.222/2 - Shtrese binderi me granil gur kave, t=6cm, perhapur e ngjeshur me makineri, eshte ofertuar 850 lekë/m2, me zërin material binder me çmimin 4270 lekë/ton dhe bitum 55 lekë/kg.

Duke e krahasuar me çmimin 1664 lekë/m2, sipas MANUALIT TEKNIK TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE, të miratuar me VENDIM Nr. 629, datë 15.7.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) (i përditësuar), ulja nga manuali eshte 49%.

*Po të marrim në shqyrtim zërin **material binder** me çmimin e ofruar 4270 lekë/ton, ku në manual është llogaritur 9257 lekë/ton, ulja nga manuali është 54%. Kurse për **materialin bitum** me çmimin e ofruar 55 lekë/kg, ulja nga manuali eshte 35.5%.*

*Vlen per tu thkesuar fakti se çmimet e materialeve janë rritur dhe sidomos ato të përcaktuara në **AKTIN NORMATIV Nr. 10, datë 18.5.2022** (hekuri, çimento, bitumi, alumini, bakri dhe zinku). Në procedurën ne fjale, materialet e çimentos dhe bitumit janë përbëres kryesor, të cilët ndikojnë në vlerën ekonomike të ofertuar.*

Nder te tjera, pervec diferencave te konsiderueshme me cmimet e manualit, per te argumentuar oferten nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion provues/justifikues per blerjen ose kontraktimin e materialeve te mesiperme te paraqitur ne analizat perkatese, ne menyre qe cmimi i materialeve te jete i argumentuar.

Per arsyet e lartpermendura, Komisioni i Vleresimit te Ofertave nuk merr parasysh argumentimin e operatorit ekonomik CAUSHI M per oferten anomalisht te ulet.

KVO vendos qe ofertuesi CAUSHI M te mos kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **K.TURJA me NIPT: K81314014A**, me adrese: Durres Bubq BUDULL Budull, prane Ures se Gjoles , se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5'377'600 lekë [pesëmilion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind] lekë pa Tvsh / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Durres, Njesia e Prokurimit, njesia.prokurimeve@durres.gov.al] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [5'986'744], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO

JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Emiriana Sako